



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.98/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në përbërje nga gjyqtari individual Burim Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.L, Komuna e Kaçanikut, të cilin me autorizim e përfaqëson A.I avokat nga Prishtina , kundër të paditurës FI.I me seli në Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson V.R avokat nga Prishtina , për kompensim dëmi, duke vendosur sipas propozimit të paditurës për përsëritje të procedurës e përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.1795/14 i datës 24.01.2019, duke vendosur jashtë seance me datë 30.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar propozimi për përsëritjen e procedurës i të paditurës F.I.C.P Kosova me seli në Ferizaj me të cilën ka kërkuar që të lejohet përsëritja e procedurës dhe të anulohet aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik C.nr.123/12 i datës 24.01.2019, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac.nr.1795/14 i datës 24.01.2019.

A r s y e t i m

E paditura-propozuesja në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës me propozim që gjykata e shkallës së dytë të lejojë përsëritjen e procedurës, të anulojë aktgjykimin e plotfuqishëm të gjykatës së shkallës së parë dhe të shkallës së dytë të cekur sikurse në dispozitivi të këtij aktvendimi, me arsyetimin se atë gjatë procesit gjyqësor të

zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe të dytë, nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar dhe po ashtu e paditura nuk ka qenë palë në procedurë.

Paditësit i është dorëzuar një kopje e parashtrësës për përsëritjen e procedurës dhe i njëjti ka dhënë përgjigje, duke i kontestuar shkaqet për të cilat kërkohet përsëritja e procedurës, nga e paditura, me arsyetimin se të paditurën e ka përfaqësuar i autorizuari i saj G.T, avokat nga Prishtina, ka propozuar që përsëritja e procedurës të refuzohet e pa bazuar.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit si gjykatë e shkallës së dytë për të vendosur në lidhje me propozimin për përsëritjen e procedurës, në përbërje prej një gjyqtari përcaktohet me dispozitën e nenit 235 e cila parasheh se: “Mbi propozimin për përsëritjen e procedurës vendosë gjykata e shkallës së dytë, dhe atë gjyqtari individual i cili nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të shkallës së dytë në procedurën e mëparshme”.

Gjyqtari i çështjes pasi që shqyrtoi pretendimet lidhur me shkaqet e paraqitura në propozimin për përsëritjen e procedurës gjeti se:

Propozimi i të paditurës-propozueses për përsëritjen e procedurës është i pabazuar.

Gjykata e Apelit pasi që shqyrtoi propozimin për përsëritjen e procedurës sipas shkaqeve të pretenduara që mund të përbëjnë bazë për përsëritjen e procedurës, gjeti se nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara që të lejohet përsëritja e procedurës sipas pretendimeve të propozuesit.

Sipas dispozitës së nenit 232 pika a) e LPK-së, gjykata mund ta lejojë përsëritjen e procedurës sipas propozimit të palës: “Në qoftë se palës me veprim të kundërligjshëm, e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore” apo kur palën ndërgjyqëse nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi i autorizuar neni 232 pika b) të LPK-së.

Mbi këtë bazë gjykata më e lartë ka vlerësuar pretendimin e të paditurës se nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar apo se nuk ka mundur të jetë palë në procedurë janë të pa qëndrueshme.

Të paditurën e ka përfaqësuar përfaqësuesi me autorizim G.T avokat nga Prishtina, ndërsa e paditura i ka plotësuar kushtet për të qenë palë në procedurë kontestimore ashtu siç parashihet me ligj dhe në këtë drejtim pretendimet ankimore janë të pa qëndrueshme dhe mbi bazë të këtyre pretendimeve nuk mund të lejohet përsëritja e procedurës kontestimore, siç pretendon e paditura.

Nga këto arsye gjykata e apelit vlerëson se e paditura në propozimin për përsëritjen e procedurës nuk ka dhënë ndonjë arsye për këtë bazë dhe nga shikimi i shkresave të lëndës konstatohet se nuk ekzistojnë rrethanat për të lejuar përsëritjen e procedurës, sipas shkaqeve të përcaktuara në nenin 232 pika a) dhe b) të LPK-së.

Nga arsyet e lartcekura gjykata e apelit vlerësoi dhe vendosi se propozimi për përsëritjen e procedurës është i pa bazuar, ndërsa për të vendosur si në dispozitiv të aktvendimit iu referua dispozitës së nenit 239 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Cn.nr.981/2021 me datë 30.05.2023

Kryetari i kolegjit

Burim Shala d.v,

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, prej ditës së dorëzimit, trupit gjykues të Gjykatës së Apelit-neni 240.4 të LPK-së